



UNËRSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
ISA BOLETINI
FAKULTETI JURIDIK

Pranuar me dt 13.12.19			
Njësia org	Numer	Nr ekzempli	Vlera
	139		

UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Fakulteti	Juridik
Lëndët për të cilat është shpallur konkursi	E drejta Kushtetuese; Gjyqësia Kushtetuese; Procedura Administrative; E drejta e Vetëqeverisjes Lokale; Filozofia e së Drejtës; Metodologjia dhe Shkrimi Ligjor.
Kandidatët e paraqitur:	Dr.sc. Përparim Gruda

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar	Prof.Dr. Enver Hasani
2. Anëtar	Prof.Dr. Qerim Qerimi
3. Anëtar	Prof.Ass.Dr. Islam Qerimi

Shënimet për kandidatin/en për të cilin/en shkruhet raporti

Kandidati/ja 1

Emri dhe mbiemri	Përparim Gruda
Datëlindja dhe vendlindja	12.04.1989, Polac, Skenderaj
Grada shkencore	Dr.sc.
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	Asistent
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	2016
Universiteti/fakulteti/departamenti	Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", Fakulteti Juridik
Arsimimi i lartë	
Studimet themelore-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik, Titulli i fituar: Jurist i Diplomuar Bachelor, Viti 2013, Nota mesatare 9.15.
Studimet master/Magjistraturë, Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik, Titulli i fituar: LL.M. (Master) në të drejtën kushtetuese dhe administrative, Viti 2014, Nota mesatare 9.70.
Studimet e doktoratës-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i doktorimit	Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut, Fakulteti Juridik, Titulli i fituar: Doktor i Shkencave Juridike në lëmin: Sistemet Politike Bashkëkohore, Viti 2019, Nota mesatare 9.75, Titulli i temës së doktoraturës: Kontrolli kushtetues në demokracitë e reja-rasti i Kosovës

Sqarim: Në këtë tabelë paraqitën shënimet për secilin kandidatë që i shkruhet raporti. Të shtohën tabela, varësisht nga numri i kandidatëve.

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit, Tabela I:

Tabela I: Punimet e publikuara pas thirrjes së fundit në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 PARIMET E NJOHJES SË PLATFORMAVE DHE REVISTAVE NDËRKOMBËTARE ME RECENSION dhe Udhëzimit Administrativ për PLOTËSIMIN DHE PRECIZIMIN – (ANEKS – I – MASHT) Nr. 7/2018 e UA Nr. 01/2018 PARIMET E NJOHJES SË PLATFORMAVE DHE REVISTAVE NDËRKOMBËTARE ME RECENSION si dhe Rregullores së UMIB, numër protokoll 1201, datë 11.09.2018.

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Platforma	Koeficienti i Revistës (indeksi mi)	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues ¹
1	Përparim Gruda	Parliament Immunity And Building Democracy In Kosovo	EBSCO DOAJ	1844-8062	Acta Universitatis Danubius. Juridica	Vol 14, no. 2, fq. 133-143, viti 2018	<p>Linku i punimit: http://journals.univ-danubius.ro/index.php/juridica/article/view/5210</p> <p>Linku i indeksimit të revistës në bazat akademike "EBSCO": https://www.ebscohost.com/titles/Lists/e5h-coverage.htm</p> <p>Linku i indeksimit të revistës në bazat akademike "DOAJ": https://www.doaj.org/toc/2065-3891?source=%7B%22query%22%3A%7B%22filtered%22%3A%7B%22filter%22%3A%7B%22bool%22%3A%7B%22must%22%3A%5B%7B%22terms%22%3A%7B%22index.issn.exact%22%3A%5B%221844-8062%22%2C%22065-3891%22%5D%7D%7D%2C%7B%22term%22%3A%7B%22type%22%3A%22article%22%7D%7D%5D%7D%7D%2C%22query%22%3A%7B%22match_all%22%3A%7B%7D%7D%7D%2C%22size%22%3A100%2C%22source%22%3A%7B%7D%7D</p>

Sqarim: Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve.

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UMIB-it dhe Rregulloren e UMIB-it me numër protokoll 1201, datë 11.09.2018.

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave për punimet e radhitura në këtë tabelë. Kryetari i komisionit mund të ftohet nga Komisioni i studimeve për shpjegime plotësuese lidhur me raportin e recensionit.

¹ Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojë linkun nëpërmjet të të cilit dëshmohet indeksimi i punimit përkatësish revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën I.

(Komisioni vlerësohet të japë informata për tipin e publikimeve, për revistën në të cilën ka botuar autori duke iu referuar statusit të kandidatit në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj), "impact factorin" e revistës, shtëpinë botuese, "impact factorin" personal, etj. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur dhe i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport)

Punimi me titull "Parliament Immunity and Building Democracy in Kosovo", i autorit Dr.sc. Përparim Gruda është botuar në revistën "Acta Universitatis Danubius. Juridica". Kjo revistë është e indeksuar në dy baza të rëndësishme akademike: EBSCO dhe DOAJ. Punimi i plotëson të gjitha kriteret për tu konsideruar një punim serioz shkencor në lëmin e së drejtë kushtetuese dhe mund të shërbejë për avancim në gradën akademike për të cilën shkruhet ky raport.

Tabela II. Mentorimi

Emri Mbiemri (i kandidatit/es)	Diploma/ Niveli i studimit	Data e regjistrimit/ lejimit të punimit	Në proces	Data e përfundimit

Sqarim: Plotësohet tabela me emrat e kandidatëve të cilët i ka mentoruar pas thirrjes së fundit.

2. Pervoja në mësimdhënie universitare

(Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, universitetet ku ai ka punuar, programet akademike, kualifikimet, angazhimi në institucione jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Vitet 2016-2019: Asistent në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", Fakultetin Juridik, Mitrovicë;
 Vitet 2013-2014: Asistent në Kolegjin Evropian "Juridica", Prishtinë;
 Vitet 2014; 2015; 2016: Ligjërues në Kolegjin Evropian "Juridica", Prishtinë.

Tabela III. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj.

Nr	Autori/ët	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti
1	Përparim Gruda	Ndarja e Pushteteve- Analizë kushtetuese	Libër	Kolegji Evropian "Juridica", Prishtinë, Viti 2015

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave të radhitura në tabelën III.

Raporti i Komisionit recensues për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik 2019-020

Tabela IV. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët, workshopet në nivel ndërkombëtar dhe vendore

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti
1	Përparim Gruda	Disa çështje të raportit të kushtetutës së Kosovës me të drejtën ndërkombëtare	Revistë për Shkencat Shoqërore Vizione, ISSN 1409-8962	2016, fq 157-168
2	Përparim Gruda	Morali dhe Ligji: Një reflektim mbi debatin Hard-Fuller	Revista Juridica	2016, fq. 157-160
3	Përparim Gruda	E drejta për një proces të rregullt ligjor në kushtetutën e Kosovës	Revista Juridica	2015
4	Përparim Gruda Zahir Çerkini	Kontrolli Parlamentar i Punës së Qeverisë-Rasti i Kosovës	Constitutio, ISSN: 1409- 8962	2013, fq. 317-336
5	Florent Muqaj Përparim Gruda	Judicial control of administrative activity and advantages of reorganization of the juridical system in the Republic of Kosovo	Academicus, International Scientific Journal, ISSN 2079-3715,	2016, fq. 66-88
7	Arsim Bajrami Florent Muqaj Përparim Gruda	Konstitucionalizimi dhe kontrolli kushtetues i partive politike- rasti i Kosovës	Revista për çështje juridike dhe shoqërore E drejta	2016, fq. 35-72
8	Doruntinë Demiri Përparim Gruda	Të Drejtat e Pakicave në Republikën e Kosovës	Constitutio, ISSN: 1409- 8962	2012, fq. 163-174

Tabela V. Ligjëratat-prezantimet gojore shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar), nga lëmi i kandidatit

Nr	Autorët (renditja si në Ligjërata/Prezantim)	Titulli i ligjëratis	Lloji i ligjëratis (Konferencë, Simpozium, Punëtori, Universitet)	Viti, Vendi
1				

Tabela VI. Redaktor/Recensent në revistat akademike apo shkencore

N r	Kontributi (redaktor/rece nsent)	Autori/ët e punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recension	Vendi, Viti
1					

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqese, projektet shkencore dhe projektet e tjera në të cilat ka marrë pjesë kandidati, statusi i tij në projekt, programi prej të cilit është financuar projekti, çmimet dhe mirënjohjet, kualifikimet e ndryshme, patentat, inovacioni etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Vitet 2016-2019: U.d. Prodekan, Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", Fakulteti Juridik, Mitrovicë;

Vitet 2016-2017: Këshilltar i Jashtëm për Çështje Juridike i Ministrit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Qeveria e Republikës së Kosovës.

4. Mobiliteti i kandidatit/es

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore, qendrite: hulumtuese jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

--

5. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)

(Anetarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të shkurtër për titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre vetëm për një kandidat për një pozitë (ose për më tepër kandidatë, nëse ashtu është kërkuar me konkurs). Komisioni vlerësues përmbledh të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar dhe sjell konkludimin dhe propozimin e arsyetuar për kandidatin dhe titullin në të cilin propozohet (sipas kërkesave të konkursit, Statutit dhe pozitës së shpallur) për kandidatin i cili propozohet për pozitën e shpallur. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatet, ndërsa 4 kapitujt paraprake shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

Komisioni Vlerësues pasi ka shqyrtuar dosjen e kandidatit Dr.sc. Përparim Gruda, për pozitën: Një mësimdhënës për lëndët: E drejta Kushtetuese; Gjyqësia Kushtetuese; Procedura Administrative; E drejta e Vetëqeverisjes Lokale; Filozofia e së Drejtës; Metodologjia dhe Shkrimi Ligjor, konsatoj me sa vijon:

1. Kandidati Dr.sc. Përparim Gruda ka paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi dhe konkursit të shpallur nga Universiteti;
2. Kandidati Dr.sc. Përparim Gruda ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik, me notën mesatare 9.15 dhe studimet master me notën mesatare 9.70;
3. Kandidati Dr.sc. Përparim Gruda ka përfunduar studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, me notë mesatare 9.75, dhe ka marr titullin: "Doktor i Shkencave Juridike në lëmin: Sistemet Politike Bashkëkohore", duke mbrojtur temën e doktoraturës me titull: "Kontrolli kushtetues në demokracitë e reja-rasti i Kosovës".
4. Kandidati Dr.sc. Përparim Gruda ka botuar një punim shkencor me recension ndërkombëtar sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension dhe Udhëzimit administrativ për plotësimin dhe precizimin – (aneks – i – masht) nr. 7/2018 e ua nr. 01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, si dhe Rregullores së UMIB, numër protokollit 1201, datë 11.09.2018.
5. Kandidati Dr.sc. Përparim Gruda, ka punuar si asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini". Pra, ka 3 (tri) vite përvoj pune në Universitet, siç kërkohet me nenin 156 të Statutit të Përkohshëm të UMIB dhe nenin 7 të Rregullores së UMIB, numër protokollit 1201, datë 11.09.2018.

Komisioni Vlerësues, duke marr parasysh të gjitha faktet e paraqitura si më sipër, **PROPOZON** që kandidati Dr.sc. Përparim Gruda, asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", të **AVANCOHET** në gradën akademike: Profesor Asistent (Prof. Ass.).

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

1. Prof.Dr. Enver Hasani, Kryetar _____

2. Prof.Dr. Qerim Qerimi, anëtar _____

3. Prof.Ass.Dr. Islam Qerimi, anëtar _____

Datë: 11/12/ 2019

Raport im, si anëtar vlerësues për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik për Këshillin e Fakultetit Juridik

Vlerësimi im, në cilësinë e anëtarit të komisionit vlerësues për kandidatit:

Asistent Përparim Gruda

UNIVERSITETI I MITROVICËS UNIVERSITY OF MITROVICA FAKULTETI JURIDIK			
Përkohshëm			
Njesia org	Numer	Nr ekzempl	Vlera
	148		26.12.19

I nderuar Dekan i Fakultetit Juridik dhe kryetar i Këshillit të Fakultetit Juridik, Profesor Bekaj;
Të nderuar/a koleg/e të Këshillit të Fakultetit Juridik,

Siç e dini, UMIB, me vendim të Senatit, me nr. 2233, të datës 7.11.2019, i protokoluar me nr. 2291, me datën 15.11.2019, ka shpallur konkurs për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik. Në kuadër të Fakultetit Juridik është shpallur konkurs edhe për një mësimdhënës për lëndët: E drejta kushtetuese, Gjyqësia kushtetuese, Procedura administrative, E drejta e vetëqeverisjes lokale, Filozofia e së drejtës, Metodologjia dhe shkrimi ligjor.

Këshilli i Fakultetit Juridik për këtë çështje ka formuar komisionin vlerësues me këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Enver Hasani, kryetar;
2. Prof. Ass. Dr. Qerim Qerimi, anëtar dhe
3. Prof. Ass. Dr. Islam Qerimi, anëtar.

Prandaj, une, si anëtar i këtij komisioni, në bazë të analizimit të të dhënave të dokumentacionit të disponuar në dosjen e kandidatit të lartpërmendur, si anëtar i komisionit vlerësues e respektoj afatin e kërkuar në harmoni me Statutin e Përkohshëm të UMIB-it, i cili në Neni 153 Pika 6. Përcakton se: "Komisioni vlerësues i raporton këshillit që e ka formuar, në afat të caktuar", deklarohem se **vlerësimi** im, për lëndën e kandidatit të sipërcekur është :

- **negativ**,

me **arsyetim** siç vijon:

Pasi që në Rregullore për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emerimit të personelit akademik në UMIB, nr. Prot. 1201, të dt. 11.09.2018, në Neni 14 përcaktohet se "Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur (lidhje të fortë) dhe elektronike", si dhe në Neni 15, Pika 1 8. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit, këtë Rregullore, kushtet e konkursit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me Neni 15. Pika 21 ku përcaktohet si vijon: "Për kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të ceken kushtet të cilat nuk i kanë plotësuar", atëherë, une, si anëtar i komisionit bazohem në Neni 15, Pika 23 ku përcakton se "Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit vlerësues ka mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për emërimin, riemërimin ose avancimi në kandidatit, ai anëtar është i obliguar që të paraqesë një "**propozim të ndarë**" për Këshillin e Fakultetit përkatës", si dhe njëkohësisht duke u bazuar edhe në Neni 25 i cili precizon si vijon: "Anëtarët

e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara ne raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë do të sanksionohen sipas kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi , nëse të njejtat bien qartazi ndesh me Statutin e UMIB-it dhe këtë Rregullore“, **deklarohem kundër rekomandimit pozitiv**, meqë nga dokumentet e bashkëngjitura të kandidatit, që ka konkuruar, **Asistent Përparim Gruda** (si kandidatë i vetëm për këtë grupë të lëndëve), siç parashihet në kuadër te kushteve të përgjithshme dhe të veçanta që janë paraparë për zgjedhjen e stafit akademik të përcaktuara me dispozitat e Statutit të Përkohshëm të UMIB-it, Rregullores nr. 1201, dt. 11.09.2018 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, avancimin e personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini“ dhe UA të MPMS nr. 07/2017 për rregullimin të konkursit në sektorin publik, **mungon diploma e nostrifikuar e doktoratës, e fituar në Universitetin e Tetovës, Republika e Maqedonisë, e lëshuar me datë 04.11.2019**, e cila do të duhet të arrihte barasvlerëshmërinë së pari nga komisioni për barasvlerësim, që e themelon Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës, **e ku do të përcaktohej qartë fusha e doktoratës, se ‘a është në harmoni me lëndët e shpallura në konkurs**, si dhe ky fakt është përcaktuar si kriter i përgjithshëm për procedimin e mëtutjeshëm të kësaj lënde.

Prandaj, potencoj se nga dokumentet në disponim të kandidatit të sipërcekur, që i ka paraqitur me këtë kërkesë, vërehet qartë se mungon diploma e nostrifikuar e doktorates nga MASHT-i, e Republikës së Kosovës, *shih* radhitjen:

- “1. Kërkesen për aplikim dhe Biografinë (CV);
2. Diplomat e noterizuara bachelor, master dhe te doktoratures;
3. Vertetimin e aplikimit per nostrifikim te doktoratures;
4. Vendimin per zgjedhjen ne poziten e asistentit ne Fakultetin Juridik të UMIB;
5. Dëshmine nga gjykata qe nuk jam nen hetim;
6. Publikimet shkencore ne revista kombetare dhe nderkombetare;
7. Librin e botuar;
8. Certifikaten per perfundimin e trajnimit per Legal Pedagogy;
9. Certifikaten per perfundimin e trajnimit per Kerkimet ligjore ne internet;
10. Certifikaten per perfundimin e EU Summer School;
11. Certifikaten per perfundimin e trajnimit Introduction to Public Speaking.”.

Prandaj, si përfundim dua të ripotencoj qartë se, në dokumentet e nevojshme për aplikim kandidati, asistent Përparim Gruda nuk e ka plotësuar kushtin themelor në harmoni me nr. II, Pika 1. shkronja d, e konkursit të shpallur, i cili parasheh decidivisht si vijon se: “kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit, me rastin e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim, duhet ta sjellin vendimin për nostrifikimin (barasvleren) e diplomes përkatëse (bachelor, master/magjistrature, doktorate).

Duke ju falenderuar për mirëkuptim,

Sinqerisht,

Prof. Ass. Dr. Islam Qerimi – Prodekan për mësim, Fakulteti Jurdik - UMIB

Me datë 26.12.2019, Mitrovicë